

Emertimi dhe Forma Ligjore "PALUSHI" SH.P.K
NIPT-i K12202004R
Adresa e Selise Rr. "Xhorxhi Martini" Nr.8 Tirane
Data e krijimit 16.Mars. 1998
Nr.i Regjistrit Tregtare 3710068
Veprimtaria NDERTIM

PASQYRAT FINANCIARE


(Ne zbatim te Standarteve Kombetare te Kontabilitetit nr.2
dhe Ligjit Nr. 9228, date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare")

Viti 2013

Pasqyrat Financiare jane individuale	PO
Pasqyrat Financiare jane te konsoliduara	JO
Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne	LEKE
Pasqyrat Financiare jane te rumbullakosura ne	LEKE

Periudha Kontabel e pasqyrave Finaciare nga 01.01.2013-31.12.2013

Data e mbylljes se Pasqyrave Finaciare 25.02.2014



ENTITETI "PALUSHI" sh.p.k
BILANCI VITI 2013

Nr	AKTIVET	Shenime	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
I	AKTIVET AFATSHKURTERA		446,739,044	424,808,017
1	Aktive monetare		9,365,904	1,176,745
i	Banka		868,390	962,162
ii	Arka		8,497,514	214,583
2	Derivate dhe aktive te mbajtura per tregtim			
3	Aktive te tjera financiare afatshkurtra		397,388,096	290,985,459
i	Llog./kerkesa te arktueshme klient per shitje		397,373,214	290,985,459
ii	Llog./kerkesa te arktueshme debitore te tjere			
iii	Tatim mbi fitimin			
iv	TVSH		14,882	
v	Te drejta e detyrime ndaj ortakeve			
vi	Instrumenta te tjera borxhi			
vii	Investime te tjera financiare			
4	Inventaret		39,985,045	125,169,458
i	Lende e pare (gjendje matriale 31.12)		77,003	94,562
ii	Inventare i imet			
iii	Prodhime ne proces (sit, ndertimi me tvsh)		39,908,042	125,074,896
iv	Produkte te gatshme			
v	Mallra per rishitje			
vi	Parapagese per furnizime			
5	Aktive biologjike afatshkurtra			
6	Aktive afatshkurtra te mbajtura per rishitje			
7	Parapagime dhe shpenzime shtyra		-	7,476,355
i	Shpenzime te periudhave te ardhshme		-	7,476,355
ii				
II	AKTIVE AFATGJATA		485,772	503,111
1	Investimet financiare afatfhata			
2	Aktive afatgjata matriale		485,772	503,111
i	Toka			
ii	Ndertesa			
iii	Makineri dhe paisje (komjuter e paisje zyre)		246,146	220,908
iv	Aktive te tjera afatgjata matriale		239,626	282,203
3	Aktive biologjike afatgjata			
4	Aktive afatgjata jo matriale			
5	Kapitali aksioner i pa paguar			
6	6 Aktive te tjera afatgjata			
	TOTALI I AKTIVEVE (I+II)		447,224,816	425,311,128

ENTITETI "PALUSHI" shpk Bilanci VITI 2013

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALE	Shenime	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
I	PASIVE AFATSHKURTRA		70,942,165	70,168,311
1	Derivatet			
2	Huamarrjet		-	-
i	Huate dhe obligacionet afatshkurtra			
ii	Rikthimet/ripagesat e huave afatgjata			
iii	Bono te konvertueshme			
3	Huat dhe parapagimet		70,942,165	70,168,311
i	Te pagueshme ndaj furnitoreve		65,508,259	67,476,164
ii	Te pagueshme ndaj punonjesve		1,676,075	1,432,267
iii	Detyrime per Sigurime Shoq-Shend.		136,432	192,053
iv	Detyrime tatimore per TAP-in		40,096	83,038
v	Detyrime tatimore per Tatim Fitimin		3,581,303	635,123
vi	Detyrime tatimore per TVSH-ne		-	349,666
vii	Detyrime tjera shteti tatimore			-
viii	Te drejta e detyrime ndaj ortakeve			-
ix	Dividente per t'u paguar			
x	Debitore dhe Kreditore te tjere			
4	Grantet dhe te ardhurat e shtyra			
5	Provizionet afatshkurtra			
II	PASIVET AFATGJATA		8,756,143	14,519,022
1	Huat afatgjata		8,756,143	14,519,022
i	Hua, bankare afatgjate (kredi A.Gj. BKT)		8,756,143	14,519,022
ii	Bono te konvertueshme			-
2	Huamarrje te tjera afatgjata			
3	Grantet dhe te ardhurat e shtyra			
4	Provizionet afatgjata			
	TOTALI I PASIVEVE (I+II)			
III	KAPITALI		367,526,508	340,623,795
1	Aksionet e pakices (PF te konsoliduara)			
2	Kapitali i aksionereve te shoq. Meme (PF te kons.)			
3	Kapitali aksionar		20,200,000	20,200,000
4	Primi i aksionit			
5	Njesite ose aksionet e thesarit (Negative)			
6	Rezervat statutore			
7	Rezervat ligjore		8,020,000	8,020,000
8	Rezervat e tjera			
9	Fitimet e pashperndara		312,403,795	305,250,858
10	10Fitimi (Humbja) e vitit financiare		26,902,713	7,152,937
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)		447,224,816	425,311,128

Pasqyra e te Adhurave dhe Shpenzimeve VITI 2013
(Bazuar ne klasifikimin e Shpenzimeve sipas Natyres)

Nr.	Perskrimi i Elementeve	Periudha	Periudha
		Raportuese	Para ardhese
1	Shitjet neto	304,593,939	229,964,132
	a.Te ardhura nga shitjet e produkteve te prodhimit te vet	220,013,551	91,225,300
	b.Te ardhura nga shitjet e mallrave		
	c.Te ardhura nga shitjet e sherbimeve	84,580,388	138,738,832
2	Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit	-	-
	a.Prodhimi aktiveve te qendrueshme te trupezuara dhe pa trupez.		
	b.Te ardhura tatimore nga akt-kontrollet		
	d.Rimarje amortizimi ,provizionesh dhe subvensionesh		
	c .Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit		
3	Ndrysh. ne invent. prod. gatshme e prodhimit ne proces	186,680,879	71,803,618
	a.Ndryshimi I inventarit te produktit te gatshem		
	b.Ndryshimi I inventarit te prodhimit ne proces	186,680,879	71,803,618
4	Matrialet e konsumuar	32,441,549	64,385,742
	a.Shpenzime per blerjen e mallrave		
	b.Shpenzime per blerjen e lendes se pare dhe te tjera konsumi	32,441,549	64,385,742
5	Kosto e punes	3,370,800	7,325,435
	a. Pagat e personelit	2,917,850	6,527,400
	b.Shpenzime te tjera per dieta e trajtime per punojnesit		
	c,Shpenzimet per sigurime shoqerore e shendetesore	452,950	798,035
6	Amortizimet dhe zhvleresimet	2,275,652	8,145,024
	a.Amortizim aktiveve te qndrueshme dhe inventareve	99,005	105,144
	b.Provizione dhe zhvleresime	-	2,353,000
	c.Shpenzime per kuot per tu shperndare	2,176,647	5,686,880
7	Shpenzime te tjera	48,311,392	66,828,322
	a.Shpenzime per furnitura dhe sherbime nga te trete	39,760,216	45,272,959
	b.Shpenzime tatimore,doganore, taksa te ndryshme	3,222,158	2,261,198
	c.Shpenzime per penalitete dhe gjoba e te tjera te ngjashme	5,329,018	19,294,165
	d.shpenzime te tjera te shfrytezimit		
8	Totali i Shpenzimeve (shumat 4-7)	86,399,393	146,684,523
9	Fitimi (humbja) nga veprimtarite kryesore (1+2+/-3-8)	31,513,667	11,475,991
10	Te ardhura dhe shpenzime financiare nga njesite e kontrolluara		
11	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesmarrjet		
12	Te ardhurat dhe shpenzime finaciare	(1,029,651)	(1,284,487)
	a.Te ardh, e shpenz,financ, nga invest, te tjera finac, afatgjata		
	b.Te ardhura dhe shpenzime nga interesat	(1,029,651)	(1,284,487)
	c. Fitimet (Humbjet) nga kursi i kembimit		
	d.Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare		
13	Totali i te Ardhurave dhe Shpenzimeve Financiare(10+11+12)	(1,029,651)	(1,284,487)
14	Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)	30,484,016	10,191,504
15	Shpenzimet e tatimit- fitimin 10% (+ Gjoba e penalitete)x10%	3,581,303	2,938,567
16	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)	26,902,713	7,252,937
17	Humbje nga pronaret e trullit (vleresimi si shitje me çmim fiskal)		

SHENIMET SHPJEGUESE

Sqarim:

Dhenia e shenimeve shpjeguese ne kete pjese eshte e detyrueshme sipas SKK 2 Plotesimi i te dhenave te kesaj pjese eshte bere sipas kerkesave dhe struktures standarde te percaktuar ne SKK 2 dhe konkretisht paragrafit 49-55. rradha e dhenies se shpjegimeve duhet te jete:

- a) Informacion i prgjithshem dhe politikat kontabel
- b) Shenime qe shpjegojne zerat e ndryshem te pasqyrave financiare
- c) Shenime te tjera shpjeguese

- Bilanci eshte hartuar duke plotesuar kerkesat e Ligjit nr.9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" si dhe te Standarteve Kombtare te Kontabilitetit

-Politikat kontabel te ndjekura nga shoqeria ne hartimin perfundimtare te Pasqyrave Financiare mbyllur me 31.12.2013 jane ato te pasqyruara ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

-Hartimi I Pasqyrave Financiare te Shoqerise eshte bere nga z. Sabri Dogjani me detyre Financier i shoqerise i punesuar me kontrate me kohe te plote dhe i siguruar prane shoqerise "Palushi" shpk.

-Kontabiliteti mbahet me ane te regjistrimeve kontabel ne informatike, duke perdorur sistemin centralizator, qe na mundeson pasqyrimin e sakte e te plote te informacionit kontabel, qe eshte i domosdoshem per hartimin e Pasqyrave Financiare.

-Pasqyrat Financiare te shoqerise jane te plota dhe te sakta duke shprehur qarte gjendje ekonomike dhe financiare te shoqerise me 31.12.2013.

-Rezultati i vitit ushtrimore 2013 eshte nxjerre ne rruge te drejte kontabile, duke pasqyruar te plota te gjitha te ardhurat dhe shpenzimet e ushtrimit, duke nzjerre keshtu nje rezultat te plote dhe te sakte ne fund te vitit.

-Shpjegime konkrete mbi hartimin e Pasqyrave Financiare te shoqerise jane ne pasqyren e Shenimeve Shpjeguese bashkangjitur Pasqyrave Financiare.

SHENIMET SHPJEGUESE

>Per vitin 2013 Shoqeria "Palushi" shpk ka patur ne proces ndertimi nje pallat me adrese Rr. Besim Alla, Komuna Kashare Tirane.

>Ne analizen e shpenzimeve te vitit ushtrimore eshte treguar kujdes lidhur me amortizimin e takses se lejes se ndertimit te parapaguar ne fillim te ndertimit si dhe te shpenzimeve te fillimit per prishjen e shpive te pronareve te truallit duke bere amortizimin e ketyre shpenzimeve ne raport me nivelin e punimeve dhe konkretisht per kete vit eshte amortizuar shuma 2 176 647 leke per taksen e lejes se ndertimit dhe shuma 5 299 708 leke per prishjen e shtepive te pronareve te truallit duke e klasifikuar edhe si shpenzime te pa njohura fiskale. Gjithashtu per te patur nje rezultat sa me te drejte per paraqitur ne menyre sa me reali rezultatin e vitit shperndarja e kostove te permendura me siper eshte bere gjithmone duke ruajtur raportet ne lidhjem me realizimin e vleres se investimit.

>Amortizimi i aktiveve eshte bere sipas normave te percaktuara ne ligjin per kontabilitetet dhe sipas vlereve aktuale te ketyre aktiveve.



>Ne zerin e shpenzimeve "Ndryshim gjendje prodhimi ne proces" eshte amortizimi i kosos se ndertimit qe i takon pallatit ne proces ndertimi ne Kashare ne shumen 186 663 320 leke.

>Ne zerin "Te ardhura dhe shpenzime per interesat" jane llogaritur interesat e kredise se paguar gjate vitit 2013 kredi e marre nga shoqeria "Palushi" shpk per zgjerim aktivitetit ne Banken Nderkombetare, dhe ne RF Bank.

>Shoqeria "Palushi" shpk e mbyll kete vit me fitim neto ne shumen 26 902 287 leke sigurisht shume me larte se viti 2012 dhe kjo per faktin se gjate ketij viti u realizuar pjesa me e madhe e shitjeve.

>Pasqyra e fluksit te parave eshte plotesuar sipas metodës direkte.

Per Drejtimin e Njesise Ekonomike
ADMINISTRATORI
(**Meriman Palushi**)



Financieri

(**Sabri Dogjani**)



Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital 2013

Nie pasqyre e pakonsoliduar

NR	EMERTIMI	Kap. Aksionar	Primi i aksionit	Aksione thesari	Rez, stat, ligjore	Fit, pashperndare	TOTALI
I	Pozicioni me 31.12.2011	20,200,000	-	-	2,020,000	311,250,858	333,470,858
A	Efektet e ndryshimeve ne politikat kontabel	-	-	-	-	-	-
B	Pozicioni i rregulluar	-	-	-	-	-	-
1	Fitimi neto per periudhen kontabel	-	-	-	-	-	-
2	Dividentet e paguar	-	-	-	-	-	-
3	Rritja e rezerves te kapitalit	-	-	-	-	-	-
4	Emetimi aksioneve	-	-	-	-	-	-
II	Pozicioni me 31.12.2012	20,000,000	-	-	8,020,000	312,403,795	340,423,795
1	Fitimi neto per periudhen kontabel	-	-	-	-	26,902,713	26,902,713
2	Dividentet e paguar	-	-	-	-	-	-
3	Fitimi i pronareve te truallit llogj e ardhur	-	-	-	-	-	-
4	Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-	-
III	Pozicioni me 31.12.2013	20,200,000	-	-	8,020,000	339,306,508	367,326,508

ADMINISTRATOR
Meriman Palushi



RAPORT I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR

USHTRIMI 2013

MBYLLUR ME 31.12.2013.

Drejtuar: Asamblese se Ortakve
Shoqerise: "Palushi" shpk Tirane
Adrese; Rr. Xhorxh Martini Nr. 8 Tirane

Ne ekzekutim te misionit qe me eshte besuar nga drejtimi i shoqerise "Palushi" shpk Tirane kam nderin t'ju paraqes Raportin tim mbi llogarite vjetore dhe PF te ushtrimit qe mbulon periudhen nga 01.01.2013 deri ne 31.12.2013.

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare bashkelidhur te shoqerise "Palushi" shpk Tirane per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2013 dhe pasqyrat perkatese te te ardhurave dhe te fluksit te parase per kete ushtrim.

Pergatitja dhe deklarimi I pasqyrave financiare, situates pasurore dhe rezultatit ekonomik te shoqerise eshte pergjegjesi e drejtimit te shoqerise.

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion lidhur me keto pasqyra mbeshitetur ne auditimin tone.

Ne kemi kryer auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te planifikojme dhe te kryejme auditimet per te perfituar nje siguri te aresyeshme nese pasqyrat financiare nuk permbajne pasaktesi materiale.

Ne auditim perfshin ekzaminimin mbi baze testi te evidencave qe mbeshtesin shumat e reflektuara ne pasqyrat financiare. Eksperti nuk do te ndermarri ne asnje moment verifikimin e plote te operacioneve te regjistruara prej kontabilitetit te shoqerise suaj.

Ne auditim perfshin gjithashtu vlersimin e parimeve te kontabilitetit te perdorura dhe vlersimet e bera nga drejtuesit, si dhe vlersimin e paraqitjes se pasqyrave financiare. Ne besojme qe auditimet tona perbejne nje baze te aresyeshme per opinionin tone.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare paraqesin nje imazh te vertete dhe te singerte, sipas cdo aspekti material, gjendjen financiare te shoqerise me date 31 dhjetor 2013, rezultatet e veprimtarive te saj dhe fluksit e parase per ushtrimin e mbyllur ne ate date ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiare.

Eksperti Kontabeli Autorizuar
Dashnor Memishi
Adresa: Prane Njesis. Tatim-pagueseve te Medhenj. Tirane
Tirane me 11 Shkurt 2014



Shoqerise "Palushi" Sh.P.K.

Te nderuar zoterinj,

Une i nenshkruari Dashnor Memishi, Ekspert Kontabel i Regjistruar, duke ju falenderuar per besimin qe me dhate per te kryer kontrollin ligjor te llogarive te Shoqerise tuaj, kam nderin te paraqes raportin tim "Mbi llogarite vjetore" qe mbulon ushtrimi nga 1 Janar deri me 31 Dhjetor 2013, ne pajtim me misionin e eksperteve kontabel te autorizuar te shprehur ne licensen Nr.129 te leshuar nga IEKA dhe te detyres se ngarkuar prej jush per te kryer ekspertizen e Pasqyrave Financiare tuaj.

Raporti perveç hyrjes permban dy pjese:

1. Kontrollin e llogarive vjetore te shoqerise(PF), te tilla siç i jane aneksuar raportit.
2. Vertetimet dhe informacionet specifike te parashikuara nga ligji e qe na jane vene ne dispozicion.

Zbatimi i kerkesave qe rrjedhin nga ligji nr.9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin",ligjin "Per shoqerite tregtare", "SKK" dhe aktet e tjera ligjore dhe nenligjore kane qene objekt kryesor i kontroleve te ushtruara duke shtrire verifikimet per te gjithë periudhen ushtrimore.

Kontrolli eshte kryer mbi bazen e testimi te dokumentacionit te perdorur dhe te gjetur ne zyrat e shoqerise suaj per transaksionet ekonomiko-financiare te kryera gjate vitit dhe qe gjejne pasqyrim ne shumet e paraqitura ne llogarite financiare (PF dhe anekset e tij). Per permbushjen e misionit tim, kam vleresuar metodat dhe parimet e perdorura per mbajtjen e kontabilitetit si edhe te paraqitjes se deklarimeve financiare.


Krahas ketyre duke vezhguar plotesimin e evidences kontabile (llogarite sintetike dhe analitike, ditaret, PF dhe anekset e saj) ne menyre te permbledhur, po trajtoj me poshte konstatimet e mia.

I - OPINIONE PER LLOGARITE VJETORE DHE PF.

Kam kryer kontrollin e llogarive vjetore ne reference me rekomandimet kontabel dhe normat perkatese profesionale duke bere verifikimet e duhura per dokumentacionin e hartuar, librat kontabel te mbajtura, informacionet qe jane perdorur duke shfrytezuar teknikat perkatese te ekspertimit kontabel.

1.Zbatimi i rregullave te mbajtjes se kontabilitetit.

Kontabiliteti eshte organizuar dhe mbajtur ne pajtim me kerkesat e ligjit "Per kontabilitetin" dhe "Standartet Kombtare te Kontabilitetit". Veprimet jane regjistruar ne menyre kronologjike nepermjet programit tashme te njohur informatik sistemi centralizator i cili na lejon te marrim informacion per çdo periudhe.



2

Çdo veprim është mbështetur në dokumenta justifikuese. Veprimet janë ngurtësuar me datë 31 Dhjetor 2013. Plani i llogarive i përdorur është i njëjti me atë që parashikon SKK dhe lejon regjistrimin konform rregullave në fuqi dhe lejon përgatitjen e dokumentave përmbledhese për të plotësuar pasqyrat e llogarive vjetore (kartelat financiare, PF dhe anekset e tij).

Shoqëria dhe Biznesi : Shoqëria « Palushi » shpk Tirane është krijuar me datë 28.01.1994 dhe ka fituar status juridik me regjistrimin në gjykatën e Tiranës nr.1147, ndryshuar emrin me Vendim Gjykatë nr 19038/3 datë 21.01.2003 nga APL-Luma në « Palushi » shpk. Kapitali i shoqërisë është 20.200.000 leke, përkatesisht kapital i ortakut të vetëm z.Meriman Palushi

- Administrator i shoqërisë është z.Meriman Palushi
- Selia e shoqërisë është në Tiranë, rruga « Xhorxhi Martini »nr.8
- Aktiviteti i Shoqërisë është ajo ndërtimore dhe tregtare.

2.Verifikimi i grupeve, rubrikave dhe posteve të PF.

Gjendja financiare e aktivitetit të shoqërisë paraqitet me poshtë. Shumat e kolonës "Ushtrimi i mbyllur" rezultojnë në rregull si për aktivin ashtu edhe për pasivin e bilancit, të cilat kanë shumën totale prej 447.224.816 leke.

U kontrolluan grupet, rubrikat dhe postet për kolonat e ushtrimit të mbyllur, duke i verifikuar me saldoto e llogarive dhe rezultoi si me poshtë vijon:

AKTIVET

Në total shumën e aktiveve të shoqërisë është në shumën 447.224.716 leke e përbërë nga :


Në grupin 1 - "AKTIVET AFATSHKURTERA" Kompania Juaj me datë 31 Dhjetor 2013 ka pasur në dispozicion një shumë prej 446.739.044 leke, të cilat sipas rubrikave janë ndare:

- Rubrika "Aktive monetare" për vlerën prej 9.365.904 leke, e cila i përket
 - Postit (a) "Depozita në banke dhe llogari të tjera", e cila përfaqëson gjendjen e bankës me 31.12.2013 sipas ekstrakteve të bankës në shumën 868.390 leke.
 - Postit (b) Gjendjen në arke në shumën 8.497.514 leke.

II - Rubrika "Aktive të tjera financiare afatshkurtera" për vlerën 397.388.096 leke, e cila përbehet nga postet e mëposhtme:

Posti (a) "Kliente për shitje dhe shërbime" për vlerën 397.373.214 leke, e cila përbehet nga pronatime klient për blerje banese, mbahet në kontabilitet e analizuar dhe ndiqet rregullisht.

Posti (b) "tvsh" për vlerën 14.882 leke.



III.-Rubrika Gjendje te inventarit dhe ne proces ne shumen 39.985.045 leke e cila perbehet nga postet e meposhtme :

Posti (a) "Lende e pare" per vleren 77.003 leke.

Posti (b), „Prodhime ne proces“ ne shumen 39.908.042 leke (situacionit.me tvsh) per pjesen e pashitur te apartamenteve.

Ne grupin 2 - “AKTIVE AFATGJATA” shoqeria ka pasur nje vlere pre 485.772 leke me vleren neto te tyre. Ky grup perbehet nga rubrika e dyte:

II - Rubrika “*Aktive te qendrueshme te trupezuara*” per vleren neto, e cila perbehet nga postet e meposhtme:

Posti(a) "Aktive te tjera afatgjata materiale(inv.ekonomik)" per nje vlere neto prej 239.626 leke, per te cilat eshte kryer inventari fizik dhe rakordon me ate kontabel.

Posti(b) “Instalime teknike, makineri, kompjutera pajisje dhe vegla pune” per vleren neto te pajisjeve, instalimeve teknike dhe makinerive per 246.146 leke. Per to eshte kryer inventari fizik dhe rakordon me ate kontabel.

PASIVI.

Ne pasivin e bilancit paraqitet gjendja e llogarive te kapitalit te Kompanise dhe ajo e detyrimeve te saj, te cilat jepen si me poshte:

1- "Pasivet afatshkurtera hua dhe parapagimet" per shumen 70,942.165 leke dhe perbehet nga postet e meposhtme


- Posti "Furnitore per blerje dhe sherbime" per nje vlere prej 65.508.259 leke, i cili mbahet i analizuar dhe perfaqson furnitoret e papaguar ne fund te dhjetorit.
- Posti "Personeli" per vleren 1.676.075 leke, perfaqeson detyrin ndaj personelit.
- Posti "Sigurime shoqerore" per nje vlere prej 136.432 leke, detyrim i paguar ne janar.
- Posti " Tatimi mbi pagat " per nje vlere prej 40.096 leke, e cila eshte likuiduar ne janar.
- Posti “ Tatimi mbi fitimin “ me nje vlere prej 3.581.303 leke, e cila perfaqeson detyrimin e tatim fitimit ne fund te vitit ushtrimor.

2- "Pasivet afatgjata hua dhe parapagimet" per shumen 8.756.143 leke dhe perbehet nga postet e meposhtme

Posti- “*Hua bankare afatgjate*” per nje vlere prej 8.756.143 leke i cili perfaqeson shumen e huase per tu likuiduar ne vitet e ardhshme.

3- "Kapitali themeltar, rezervat, fitime dhe humbje" per vlere 367.526.508 leke, e cila sipas posteve paraqitet:

- Posti (a) "Kapitali i aksionare" per nje vlere prej 20,200,000 leke, i cili nuk ka ndryshim ne krahasim me vitin e kaluar.



- Poati (b) "Rezervat " per nje vlere prej 8,020,000 leke i cili perfaqeson rezerven ligjore te krijuar ne kete Kompani.
- Posti (c) "Fitimi ose Humbje te mbartura" me nje vlere prej 312.403.795 leke i cili perfaqeson fitimin e pashperndare te realizuar ne vitet e kaluara.
- Posti (d) "Fitimi (Humbje) ushtrimit" per nje vlere prej 26.902.713 leke, e cila perfaqeson fitimin neto te ushtrimit.

3. Verifikimi i llogarise Fitime - Humbje (Pasqyra shpenzime dhe te ardhura).

Pasi verifikova postet e ketyre llogarive arrita ne konkluzionin qe te dhenat jane marre nga bilanci verifikues, i cili eshte nxjerre nga saldot e llogarive gjashte per shpenzimet dhe shtate per te ardhurat. Ketu jane mbajtur parasysh edhe sistemimet e bera gjate kohes se kontrollit nga mbajtesi i kontabilitetit konform rregullave ne fuqi.


-I-TE ARDHURAT.

- Gjate vitit 2013 Kompania ka arritur te realizoje te ardhura ne nje vlere 304.593.939 leke e cila i perbehet nga:
 - Te ardhura qe hyjne ne shitjet neto.
 - Posti "Nga shitja e produkteve te prodhimit te vet" per shumen 220.013.551 leke, e cila perfaqeson shitjet e perjashtuara.
 - Posti te ardhura nga shitja e sherbimeve ne shumen 84.580.388 leke shitjet gjate ushtrimit te situacionet e ndertimit.
 Te gjitha keto jane te kuadruara me librin e shitjeve.

-II-SHPENZIMET

Gjate vitit 2013 Kompania ka kryer shpenzime qe kane bere te mundur zhvillimin e aktivitetit ne vleren prej (273.080.272) leke, te cilat ne menyre analitike ato paraqiten llogarite perkatese te shpenzimeve si me poshte:

- " SHPENZIME TE SHFRYTEZIMIT" per nje vlere prej (273.080.272) leke dhe perbehen si me poshte:
 - a) Ndryshimi i inventarit te prodhimit ne proces ne shumen (186.680.879) leke
 - b) Shpenzime per blerje te lendes se pare dhe te tjera konsumi gjate vitit ne vleren (32.441.549) leke.
 - c) Furnitura, sherbime dhe nentrajtime per vleren (39.760.216) leke, e mbahet e analizuar.
 - d) Shpenzimet per koston e punes qe perbehen nga shpenzime paga per (2.917.850) leke dhe sigurime shoqerore per (452.950) leke, qe ne total bejne (3.370.800) leke.
 - e) Shpenzime per tatime dhe taksa ka vlere (3.222.158) leke.



- f) Shpenzime te tjera rrjedhese per nje vlere prej (5.329.018) leke, edhe kjo eshte e analizuar dhe pjesen me te madhe e zene shpenzimet e panjohura per efekte fiskale.
- g) Shpenzime amortizimi per vleren (99.005) leke, e cila eshte llogaritur sipas grupeve te aktiveve .
- h) Shpenzime kuote per tu shperndare ne shumen (2.176.647) leke.

Fitim dhe humbje nga veprimtaria kryesore ne shumen 31.513.667 leke(I-II).

III. TE ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE per vleren (1.029.651) leke, e cila perbehet nga postet e meposhtme:

- (a) Te tjera shpenzime financiare per nje vlere prej (1.029.651) leke qe perfaqeson interesat e huase bankare.

Fitim dhe humbje para tatimit te fitimit ne shumen 30.484.016 leke.

C. REZULTATI I USHTRIMIT.

Nga sa me siper rezultati i ushtrimit nga veprimtaria eshte 30.484.016 leke. Nga e cila eshte zbritur Tatim fitimi per shumen (3.581.303) leke, i cili eshte llogaritur duke i shtuar shpenzimet e panjohura per efekt fiskal ne shumen 5.329.018 leke,dhe keshtu fitimi neto eshte 26.902.713 leke.

4.Anekset e tjera te bilancit.

Keto pasqyra jane plotesuar ne rregull sipas kerkesave.

II. VERIFIKIMI I INFORMACIONEVE.

Dokumenta dhe materiale te tjera te natyres kontabile dhe financiare qe gjetem dhe qe na u vune ne dispozicion jane te njejta me kontabilitetin. Raporte te tjera te veçanta dhe informacione perveç atyre qe kemi theksuar me lart, nuk na jane vene ne dispozicion, per te gjitha keto materiale nuk kam ndonje verejtje.

Ne perfundim te verifikimeve dhe kontroleve, sipas opinionit tim llogarite vjetore dhe PF qe i aneksohen ketij raporti jane te sigerta dhe te rregullta dhe japin nje pamje besnike te rezultatit nga veprimet e ushtrimit dhe te situates financiare dhe gjendjes pasurore te Kompanise Suaj me 31 Dhjetor 2013.

Eksporti Kontabel i Autorizuar

Dashnor Memishi

Adresa:Prane Njesis Tatimpagueseve te Medhenj, Tirane

Tirane me 11 Shkurt 2014

